



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 629, datë 10.12.2020

**PËR
VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATI Z. {...}
TË TRE KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË
GJYKATËN E APELIT GJIROKASTËR, GJYKATËN E APELIT DURRËS DHE NË
GJYKATËN E APELIT TIRANË PËR TRE POZICIONE TË LIRA NË FUSHËN E TË
DREJTËS CIVILE, TË SHPALLURA ME VENDIMET NR.389, NR. 392 DHE NR.395,
DATË 07.10.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE VIJIMIN E
PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PËR KRITERET E TJERA LIGJORE TË
KANDIDIMIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 10.12.2020, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, të kandidatit z. {...}”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet nr. 389, nr. 392 dhe nr. 395, datë 07.10.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr. 389, datë 07.10.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile...””.

2. Me Vendimin nr. 392, datë 07.10.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile ...”.

3. Me Vendimin nr. 395, datë 07.10.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile ...”.

4. Për të trija këto procedura të ngritjes në detyrë për në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, afati i kandidimit është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit të vendimit përkatës në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Njoftimi për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë për këtë pozicion të lirë është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 08.10.2020, duke përfunduar kështu afati i kandidimit më datë 23.10.2020.

5. Brenda afatit të kandidimit për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimet nr. 389, nr. 392 dhe nr. 395, datë 07.10.2020 ka kandiduar edhe z. {...} (më poshtë referuar si kandidati), gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, aktualisht i komanduar në skemën e delegimit për të gjykuar në gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

6. Me Vendimin nr. 541, datë 05.11.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatat e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 07.10.2020”, Këshilli ka vendosur:

“1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr.389, nr.392, nr.394, nr.395 dhe nr.396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: ...5.Për kandidatin z. {...}- relator z. Alban Toro; ...”.

7. Më datë 05.11.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor 75/2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, në rrugë elektronike, kandidati u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e

relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

8. Brenda afatit të përcaktuar kandidati nuk parashtrori ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

9. Në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe të figurës së kandidatit, në kuadër të ngritjes në detyrë, në kushtet kur kandidati është subjekt rivlerësimi “*ex officio*” sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, proces ky që për kandidaten nuk ka përfunduar, referuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Ligjin nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në pikën 2¹, Seksioni B, Kreu X, të Vendimit 75/2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Shkresën me Shkresën nr.5868 prot., datë 18.11.2020, i ka kërkuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit kalimtar ndaj kandidatit, verifikim që po vijon ndaj këtij Institucioni.

10. Më datë 10.11.2020, bazuar në pikën 8, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidatit iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

11. Brenda afatit pesëditor, kandidati depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa një nga dokumentet, pikërisht formularin e deklaratës së pasurisë, sipas Vendimit 75/2019, kandidati duhet ta dorëzojë, jo më vonë se 21 ditë nga dita e dërgimit të tij, pra deri më datë 01.12.2020, pranë ILDKPKI-së.

12. Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 19.11.2020, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e gjykatave të apelit, ndër ta edhe për kandidatit z. {...}. Për këto kriterë ligjore kandidimi procedurat e verifikimit janë në proces e sipër.

¹ “Kandidatët që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016 dhe janë në procedurë e sipër rivlerësimi ose për të cilët kjo procedurë nuk ka filluar ende, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës nga Këshilli, sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin. Vendimi i Këshillit për kualifikimin ose jo për këta kandidatë do të mbështetet në vendimin e dhënë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Në këtë rast, Këshilli i kërkon Komisionit të Pavarur të Kualifikimit trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit për këta kandidatë. Nëse Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nuk i përgjigjet kërkesës së Këshillit ose nuk përfundon procedurat e rivlerësimit për këta kandidatë brenda 3 muajve nga momenti i paraqitjes së kërkesës, këta kandidatë i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin”

13. Sipas pikës 9, të Vendimeve të Këshillit nr.389, nr. 392 dhe nr.395, datë 07.10.2020, është përcaktuar se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”*. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimeve të Këshillit nr.389, nr. 392 dhe nr.395, datë 07.10.2020, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë pranë gjykatës së shkallës së dytë përcaktohen..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës civile, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*. Nga ana tjetër, në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, përcaktohet se: *“c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

14. Në respektim të vendimit si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të tre kriterëve formale të sipërpërmendura të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, me qëllim realizimin paralelisht edhe të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, pra në funksion të përmbylljes sa më parë të procedurave të kandidimit, për kandidatin z. {...} u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykatat ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

14.1 Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me Shkresën nr.5699/1 prot., datë 09.11.2020, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidatin z. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

14.2 Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale” dhe pikërisht sa i përket “përvojës specifike profesionale” të kandidatit në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ai ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës civile, referuar gjykatave ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, konkretisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, ku u administrua informacioni i ardhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë si dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, në kuadër të procesit të verifikimit të kushteve të kandidimit të z. {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, Gjykatën e Apelit Durrës dhe Gjykatën e Apelit Tiranë. Konkretisht, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë informacioni është përcjell me Shkresën nr. 3461/3 prot., datë 13.11.2020, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë informacioni është përcjell me Shkresën nr. 534 prot., datë 10.11.2020 siç do të përshkruhet më poshtë.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR TRE KRITERET E KANDIDIMIT

15. Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”.

16. “Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë në rastin konkret në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr.389, nr. 392 dhe nr.395, datë 07.10.2020, është parashikuar si kusht kandidimi në nenin 47, pika 4, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.*

17. Për verifikimin e kandidatit në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, Durrës dhe Tiranë u mbajt parasysh se ai ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, çka do të thotë se kandidati, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale, që është jo më pak se shtatë vjet, duhet të plotësojë edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra jo më pak se pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, konkretisht në fushën e të drejtës civile për pozicionet e lira të shpallur me Vendimet e Këshillit nr.389, nr. 392 dhe nr.395, datë 07.10.2020.

18. Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati, evidentohet se ai ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2014, ndërkohë që është emëruar si gjyqtar për të kryer stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën 2013-2014. Më pas ai është emëruar përfundimisht gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ku ka ushtruar funksionin e gjyqtarit për periudhën Shtator 25-Nëntor 2020. Nga 05 Nëntor 2020 e në vijim është komanduar në skemën e delegimit për të gjykuar në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë për një periudhë deri më datë 05 Nëntor 2021.

19. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...}, ka filluar detyrën me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.8353 datë 21.10.2020, ku është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në vijim, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.9243 datë 25.09.2015, ai është emëruar përfundimisht gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë .Z. {...} ka ushtruar gjithashtu funksionin e zv. Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë prej datës 10.01.2019. Më pas, me Vendim nr. 547 datë 05.11.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është komanduar në skemën e delegimit për të gjykuar në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë për një periudhë deri më datë 05 Nëntor 2021.

20. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastër , Durrës dhe Tiranë, për pozicionet e lira (në fushën e të drejtës civile) të shpallur me Vendimet e Këshillit nr.389, nr. 392 dhe nr.395, datë 07.10.2020, ka mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë, duke plotësuar kështu kriterin “përvojës profesionale minimale”.

21. Në lidhje me përvojën specifike profesionale, në kërkesën për shprehje interesi, kandidati ka deklaruar se ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në çështjet e juridiksionit të përgjithshëm pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në seksionin e çështjeve të drejtësisë për të mitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

22. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se: {...} *fillim e detyrës e kam me dekret nr. 8656 date 21.10.2013 ku është emëruar për të kryer stazhin profesional pranë kësaj gjykate ku ka gjykuar çështje me natyrë të përgjithshme, si çështje civile/ familjare si dhe çështje penale.*

22.1 Ndërsa sipas informacionit dhe dokumentacionit në formë tabelore të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën nga 21.10.2013 -31.12.2014 ka gjykuar përkatësisht 132 çështje gjyqësore, ku nga këto:

-8 çështje janë në fushën penale, -23 çështje të përgjithshme, -11 çështje familjare, -12 masa sigurimi, - 78 çështje civile.

- *Me urdhrin “Mbi pjesëmarrjen në gjykimin e masave të sigurimit të kandidateve për magistratë”, nr. 112/1 datë 21.11.2013 kandidati është caktuar të jetë pjesë e masave të sigurimit për muajin nëntor.*
- *Me urdhrin “Mbi pjesëmarrjen në shortin civil e kandidateve magistratë”, nr. 128 datë 18.12.2013 kandidati është caktuar të gjykojë në seksionin civil familjare*
- *Me urdhrin “Mbi pjesëmarrjen në shortin civil e kandidateve magistratë”, nr. 128/1 datë 19.12.2013 kandidati është caktuar të gjykojë në seksionin civil të përgjithshme.*

23. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, për periudhën 2015 deri më tetor 2020, ka gjykuar çështje me natyrë të përgjithshme si çështje civile si dhe çështje penale pasi gjykata nuk ka pasur urdhra për ndarje në dhoma apo seksione, përveç çështjeve për drejtësinë e të miturve të krijuar si seksion më datë 11.06.20219. Gjithashtu sipas informacionit dhe dokumentacionit në formë tabelore të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë për periudhën nga 2015- tetor 2020, z. {...} ka gjykuar përkatësisht 2537 çështje gjyqësore, ku nga këto 991 janë çështje penale dhe 1546 janë çështje civile.

24. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, Durrës dhe Tiranë, për pozicionet e lira të shpallur me Vendimet e Këshillit nr.389, nr. 392 dhe nr.395, datë 07.10.2020, ka mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës specifike profesionale minimale”.

25. Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

26. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter për ngritjen në detyrë edhe në gjykatën e shkallës së dytë, që gjen reflektim në shkronjën “c”, të pikës 5, të Vendimet të Këshillit nr.389, nr. 392 dhe nr.395, datë 07.10.2020, është parashikuar në nenin 48, pika 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “*Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë*”.

27. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 22.10.2020, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “*Nuk kam masë disiplinore në fuqi*”.

28. Sipas informacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

29. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet që kandidati z. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi, duke plotësuar kështu kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

30. Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

31. Papajtueshmëria ambientale si kriter ndalues për ngritjen në detyrë edhe në gjykatën e shkallës së dytë, që gjen reflektim në shkronjën “ç”, të pikës 5, të Vendimet të Këshillit nr.389, nr. 392 dhe nr.395, datë 07.10.2020, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “*Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproporcionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë*”. Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: “*Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e*

tij deri në shkallë të dytë”. Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”*.

32. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 22.10.2020, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

33. Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ai kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, Durrës dhe Tiranë.

34. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidatin Këshilli vlerëson se z. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke plotësuar kështu kriterin e *“papajtueshmërisë ambientale”*.

III. KONKLUZIONE

35. Referuar kërkesave të Vendimit 75/2019, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimeve Këshillit nr.389, nr. 392 dhe nr.395, datë 07.10.2020, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit të z. {...} për ngritjen në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

36. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit për kandidatin z. {...}, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e tij nga kandidimi në lidhje me këto kriterë. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, të tre kriterëve të sipërpërmendura të kandidimit dhe vijim e procedurës

së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore për pozicionet të lira në fushën e të drejtës civile me Vendimet nr.389, nr. 392 dhe nr.395, datë 07.10.2020.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, si dhe në pikën 9, të Vendimit të tij nr. 389 datë 07.10.2020, “Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”, Vendimit nr. 392 datë 07.10.2020, “Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile” si dhe Vendimit nr. 395 datë 07.10.2020, “Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Verifikimin e plotësisë nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimet e Këshillit nr.389, nr. 392 dhe nr.395, datë 07.10.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, për tre pozicione të lira në fushën e të drejtës civile me Vendimet nr.389, nr. 392 dhe nr.395, datë 07.10.2020.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqjen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR